

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NOTERE MAJLINDA LLESHI  
Rr" Sulejman Delvina"  
Tel 0035542234555  
Nr. 445 Rep  
Nr. 171 Kol



KONTRATE SHITJE  
Të Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë  
"AERTERMIKA" SHPK

Sot në Tiranë, më datë 02.02.2015, përpara meje Noterit Majlinda Lleshi, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqiten personalisht:

**SHITËSI:**

**Edison SHEMA**, i biri i Mustafait i datelindjes 29.09.1975, lindur ne Vullnetari Elbasan dhe banues ne Tirane ne adresen Rr Brigada VIII, P.8, madhor dhe me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar i identifikuar me Leternjoftimin ID Nr 024432662, me cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise "AERTERMIKA" sh.p.k. me NIPT (NUIS) Nr. L32315021J, me adresë ne Tirane ne rruga Stavri Themeli, P. Shushica, Hyrja 1, Nr. 1, i cili merr pjesë në këtë kontratë në cilësinë e "**SHITËSIT**";

**BLERËSI:**

**Adriatik Zeqillari**, i biri Takos, i datelindjes 10.08.1964, lindur ne Kelcyre, Permet dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar i identifikuar me Leternjoftimin ID Nr 028930034, i cili merr pjesë në këtë kontratë në cilësinë e "**BLERËSIT**".

*Palët e kësaj kontrate, janë të gjithë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga dokumentet identifikuuese që ata më paraqitën. Palët kanë rënë dakord që të lidhin këtë Kontratë Shitje me përbajtje si më poshtë vijon:*

**KUSHTET PARAPRAKE**

Shitësi zotëron 100(njeqind) Kuota, që përbëjnë 100% të kapitalit të Shoqërisë "AERTERMIKA" SHPK, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L32315021J, me seli në Adresën: Rr Stavri Themeli P Shushica, Hyrja 1, Nr. 1.

**Shitësi, njëkohësisht dhe Ortak i vetem i Shoqërisë "AERTERMIKA" SHPK, me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, të datës 02.02.2015, ka vendosur:**

Miratimin e Rendit të Ditës;

Transferimi nepermjet shitjes 100%te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren totale prej 1.000.000 leke, nga Ortaku i vetem Z. Edison Shema tek bleresi z. Adriatik Zeqillari. Vlera nominale e nje kuote eshte 10.000 leke.

Me nenshkrimin e Kontratës së Shitjes dhe shlyerjen e plotë të çmimit nga Blerësi, kapitali i Shoqërisë "AERTERMIKA" SHPK, do të zotërohet nga Z. Adriatik Zeqillari;

Blerësi, përpara meje noterit deklaron se është dakord që të blejë 100(njeqind) kuota, qe perbejne 100 % të kapitalit të shoqërisë tregtare "AERTERMIKA"SHPK

## SHITJA

Ortaku i vetem i Shoqërisë "AERTERMİKA"SHPK, njëkohësisht dhe pala shitëse në këtë kontrate i shet 100(njeqind) kuota që përbëjnë 100 % të kapitalit të Shoqërisë " AERTERMİKA " SHPK, blerësit, z. Adriatik Zeqillari,

## PAGESA E ÇMIMIT TË SHITJES

Pagesa e çmimit të shitjes së kuotave ne vleren prej 1.000.000 leke (nje milion leke) është shlyer plotësisht nga BLERËSI.

## KALIMI I PRONESISE

Menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitje nga të dy palët dhe Noteri, 100(njeqind) kuota që përbëjnë 100 % të kapitalit të Shoqërisë " AERTERMİKA " SHPK, do të zotërohen plotësisht nga z. Adriatik Zeqillari.

## TË TJERA

Shitësi deklaron se shoqëria tregtare "AERTERMİKA"SHPK nuk ka detyrime ndaj të tretëve përfshire dhe ndaj ortakëve si dhe ndaj organeve tatumore.

Shitësi deklaron dhe garanton se kuotat e tyre janë te lira dhe pa asnje barrë.

Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria Tregtare "AERTERMİKA"nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje siguruese, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë. Nëse një gjë e tillë ekziston atëherë përgjegjësia është e shitësit.

Shitësi deklaron me vullnetin e tij se do të përgjigjet në mënyrë solidare dhe paasnje kufizim, për të gjitha detyrimet e shoqërisë tregtare "AERTERMİKA"SHPK që mund të dalin deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate;

Përgjegjësia e blerësit për detyrimet e shoqërisë, fillon që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve përfshire dhe institucionet shtetërore, që nga data e krijimit deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, janë përgjegjësi e shitësit.

Për të gjitha konfliktet që mund të lindin nga zbatimi i këtij nenë nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim nga palët, atehorë kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## HYRJA NË FUQI DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Palët do të tregojnë seriozitetin e duhur për zgjidhjen e konflikteve që mund të dalin nga zbatimi i kësaj kontrate. Në rast të kundërt, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet ne 3 (tre) kopje me vlerë të njëjtë, ndër të cilat, një kopje mbahet në zyrën e noterisë, ndërsa të tjera ndahen ndërmjet palëve.

Pasi unë Noteri ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Kontrate, të cilët më deklaruan se e kuptojnë, pranojnë dhe se është hartuar në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, e vërtetoj këtë Kontratë Shitje sipas ligjit.

PALËT

SHITËSI  
Edison SHEMA

Edison Shema  
Signature



BLERËSI  
Adriatik ZEQILLARI

Adriatik Zeqillari  
Signature